



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 176, Datë 18.05.2023

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 MW, NË ZONËN E ERSEKËS,
BASHKIA KOLONJË, QARKU I KORÇËS**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 884/12 prot., datë 17.05.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës”.

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 64, datë 03.03.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 04.03.2023 dhe 05.03.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 02.04.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s.

- Në vijim, duke qënë se nga ana e shoqërisë nuk ishte depozituar ende miratimi përfundimtar për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit, por shoqëria kishte bërë me dije në emailin e datës 27.04.2023 se pritej të merrte këtë miratim brenda 7 ditëve, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 156, datë 02.05.2023, vendosi të zgjasë deri në 20 ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me tej, me shkresën nr. 884/11 prot., datë 08.05.2023, shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. ka depozituar “Marrëveshjen Për Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit të Parkut Fotovoltaik “Erseka Solar Park 1”, duke plotësuar tërësisht dokumentacionin e munguar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të Rregullores së licencimit.
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastin konkret shoqëria ka plotësuar në formatin e aplikimit se afati i pritshmërisë së centralit fotovoltaik është 35 vjet, ndërkohë rezulton se ka dokumentuar që garancia e tij është 30 vjet, ndaj në këto rrethana ERE kushtëzohet nga kjo garanci dhe nga Ligji nr. 43/2015 në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, për 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI